

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

SHTRIM DHE VESHJE
ME PLLAKA
Niveli II

(Në drejtimin mësimor Ndërtim)

Kodi: B2-II-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II, të drejtimit mësimor “Ndërtim”

1. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II
2. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II
3. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II
4. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II
5. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

III. Plani mësimor për profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II, të drejtimit “Ndërtim”

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II të drejtimit “Ndërtim”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shtrimin dhe veshjen me pllaka. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:*

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse dhe ta organizojë atë.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të volumeve dhe materialeve që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë punime për shtrojë nënshtresa të nderkateve, terracas të dyshemeve të katit përdhe dhe të bodrumit.
- Të kryejë punime për shtresen niveluese të dyshemesë, si dhe për dyshemene monolite e trotualet e ndërtesës.
- Të shtrojë dysheme monolite në mjedise të brendshme të ndërtesave të ndryshme.
- Të kryejë punime për hidroizolim, zëizolim dhe termoizolim të nderkateve e terraces.
- Të kryejë punime për shtrojë dyshemete me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe të jashtme e trotualet e ndërtesave të ndryshme.
- Të shtrojë dysheme me copa (me fuga) në mjedise të jashtme si dhe në rrugë e trotualet.
- Të kryejë punime për veshjen me pllaka e materiale të tjera të mureve në mjedise të brendshme të ndërtesave të ndryshme.
- Të kryejë punime për veshjen me pllaka e materiale të tjera të mureve të fasadave (dekorative).

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në sipërmarrje ndërtimi ose tregtimi shtetërore/private si punëtor i kualifikuar në punime shtrimi/veshje me pllaka dhe materiale të tjera dhe riparimet e tyre ose mbas një përvoje pune të vetëpunësohet si sipërmarrës duke punësuar individë të tjerë në veprimtari të shtrimit dhe veshjes me pllaka dhe materiale të tjera.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ Vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-01-175-18	Vizatimet e ndërtimit	1
3	L-02-176-18	Teknologji shtrimi dyshemesh dhe veshje muresh	2
4	L-02-177-18	Teknologji konstruksionesh mbajtëse	1
5	L-02-478-18	Teknologji shtrimi rrugësh dhe trotuarësh	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-02-465-18	Punim i nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve	102
2	M-02-1460-18	Punime shtrimi dyshemesh me copa në mjedise të brendshme dhe të jashtme	135
3	M-02-469-18	Veshja me pllaka e mureve të mjediseve të brendshme	102
4	M-02-470-18	Veshja me pllaka e fasadave	69

D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-02-471-18	Shtrimi i dysHEMEVE me asfaltobeton	51
2	M-02-472-18	Shtrimi i dysHEMEVE monolite prej betoni të armuar	51
3	M-02-473-18	Veshja e fasadave me pllaka mermeri	51
4	M-02-474-18	Veshja e mureve të mjediseve të brendshme me letër dekorative	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i “*të nxënësit duke bërë*” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat

profesionale të profilit mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Shtrim dhe veshje me pllaka”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e shtrimit të pllakave e veshjes së mureve, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Shtrim dhe veshje me pllaka”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjitha elementet kryesore të saj.
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore.
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes.
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes.
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të.
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kwrkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje.
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes.
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre.
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut.
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut.
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërëse të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës.
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për Marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

2. Lënda “Vizatimet e ndërtimit” (L-01-175-18). Kl. 12 - 34 orë

- Synimet e lëndës “Vizatimet e ndërtimit”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatimet e ndërtimit”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të lexojnë shenjat dalluese që përdoren në fletët e vizatimeve të ndërtimit.
- Të vizatojnë shenjat dalluese që përdoren në fletët e vizatimeve të ndërtimit sipas tabelës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planimetrisë së kateve dhe bodrumit të ndërtesës.
- Të vizatojnë planimetritë e kateve dhe bodrumit të një objekti të thjeshtë dykatësh sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planimetrisë së themeleve dhe prerjeve të tyre të ndërtesës.
- Të vizatojnë planimetrinë e themeleve dhe prerjet e tyre të një objekti të thjeshtë dykatësh sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të prerjeve të ndërtesës.
- Të vizatojnë prerjet kryesore të një objekti të thjeshtë dykatësh sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të pamjeve të ndërtesës.
- Të vizatojnë pamjet kryesore të një objekti të thjeshtë dykatësh sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planit të strukturave të ndërkateve dhe shkallëve një objekti të thjeshtë dykatësh.
- Të vizatojnë planin e strukturave të ndërkateve dhe shkallëve sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të detajeve arkitektonike të ndërtesës.
- Të vizatojnë detaje arkitektonike kryesore të një objekti të thjeshtë dykatësh sipas skicës së dhënë.
- Të interpretojnë skica nga vizatimet skematike të instalimeve në objekt (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ventilim, gaz etj.) dhe shenjat dalluese të përdorura;
- Të interpretojnë skica nga vizatimet skematike të rrjetit inxhinierik në rrugë dhe trotuare (elektrik, furnizim me ujë, kanalizim etj.) dhe shenjat dalluese të përdorura.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatimet e ndërtimit”, kl. 12- 34 orë:**

Tema 1	Njohuri për vizatimet e ndërtimit	2 orë
Tema 2	Planimetritë e kateve dhe vizatimi i tyre	6 orë
Tema 3	Planimetria e themeleve, prerjet e themeleve dhe vizatimi i tyre	4 orë
Tema 4	Pamjet kryesore të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	4 orë
Tema 5	Prerjet kryesore të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	8 orë
Tema 6	Planet e strukturave të ndërkateve e shkallës b/a dhe vizatimi i tyre	4 orë
Tema 7	Detajet arkitektonike dhe vizatimi i tyre	4 orë
Tema 8	Njohuri për vizatimet skematike të instalimeve në objekt e rrjetit inxhinierik në rrugë dhe trotuare	2 orë

3. Lënda “Teknologji shtrimi dyshemesh dhe veshje muresh” (L-02-176-18). Kl. 12 – 68 orë

• **Synimet e lëndës “Teknologji shtrimi dyshemesh dhe veshje muresh”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji shtrimi dyshemesh dhe veshje muresh”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë fletët arkitektonike të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë dykatësh;

- Të interpretojnë fletët arkitektonike të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë dykatësh.
- Të përshkruajnë llojet e nënshtresave në kuotën e katit nëntokë (parkim etj.) për nivele të ndryshme të ujërave nëntokësore, si dhe llojet e materialeve që përdoren për to;
- Të përshkruajnë llojet e nënshtresave në kuotën e katit përdhe në rastin pa kat nëntokë, si dhe llojet e materialeve që përdoren për to;
- Të përshkruajnë llojet e nënshtresave në kuotën e ndërkatit, si dhe llojet e materialeve që përdoren për to;
- Të përshkruajnë llojet e instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ventilim, gaz etj.) që vendosen në muraturë dhe nën shtresat e dyshemesë, si dhe llojet e materialeve që përdoren për to;
- Të përshkruajnë llojet e shtresave në tarracat me kornizë/parapet, si dhe llojet e materialeve që përdoren për to;
- Të përshkruajnë hapat e punimeve të hidroizolimit dhe shtresave të tjera për dyshemenë në kuotën e katit nëntokë (parkim etj.) për nivele të ndryshme të ujërave nëntokësore;
- Të përshkruajnë hapat e punimeve të hidroizolimit dhe shtresave të tjera për dyshemenë në kuotën e katit përdhe në rastin pa kat nëntokë;
- Të përshkruajnë hapat e punimeve zëizoluese, hidroizoluese e termoizoluese si dhe shtresat e tjera të dyshemesë në kuotën e ndërkateve;
- Të përshkruajnë hapat e realizimit të shtresës niveluese të dyshemeve dhe dhënies së pjerrësisë së tarracave, si dhe materialet që përdoren për to;
- Të përshkruajnë hapat e punimeve termoizoluese e hidroizoluese e si dhe të shtresave të tjera të tarracave me kornizë/parapet;
- Të përshkruajnë llojet dhe hapat e realizimit të dyshemeve monolite të llojeve të ndryshme, si dhe materialet që përdoren për to;
- Të përshkruajnë hapat e realizimit të dyshemeve me copa/me fuga me materiale të ndryshme dhe me mënyra të ndryshme shtrimi.
- Të krahasojnë pwrmasat e pllakave me permasat standarde të paketimit të tyre;
- Të përshkruajnë përzgjedhjen e llojit të pllakave sipas pozicioneve të ndryshme dhe vetive të tyre;
- Të përshkruajnë hapat e përgatitjes dhe vendosjes së pragjeve të dyerve dhe plintusave.
- Të vizatojnë detaje të shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga) me mënyra të ndryshme shtrimi sipas projektit.
- Të përshkruajnë hapat e shtrimit të dyshemeve me parket prej druri e laminat dhe me materiale plastike të ndryshme.
- Të përshkruajnë hapat e realizimit të veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme të banimit (nyjet sanitare, mjedise gatimi etj.) si dhe materialet që përdoren për to.
- Të vizatojnë detaje të veshjes me pllaka të mureve të brendshme të mjediseve të banimit (nyjet sanitare, mjedise gatimi etj.) sipas projektit
- Të përshkruajnë hapat e veshjes së bazamakëve të shkallëve, korimanove, davancaleve, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve si dhe materialet që përdoren për to.
- Të vizatojnë detaje të veshjes së bazamakëve të shkallëve, korimanove, davancaleve, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve sipas projektit
- Të përshkruajnë hapat e veshjes së mureve të brendshme dekorative si dhe materialet që përdoren për to.
- Të përshkruajnë hapat e veshjes së mureve të jashtme (fasadave) me materiale të ndryshme.

- Të vizatojnë detaje të veshjes së mureve të jashtme (fasadave) me materiale të ndryshme si: sipas projektit.
- Të listojnë parregullsitë e sipërfaqeve të dyshemeve/mureve që kërkojnë punime shtesë përgatitore për shtrimin/veshjen e tyre me pllaka;
- Të përshkruajnë rrejetet e instalimeve në ndërtesë;
- Të dallojnë defektet dhe shkakun e dëmtimeve të shtresës veshëse me pllaka;
- Të përshkruajnë hapat e realizimit të rikonstruksionit të dyshemeve dhe veshjeve të mureve të brendshme e të jashtme sipas projektit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji shtrimi dyshemesh dhe veshje muresh”, kl.12- 68 orë**

Tema 1	Skicimi i planimetrive te kateve, prerjeve, fasadave, themeleve dhe detajeve arkitektonike	18 orë
Tema 2	Teknologjia e shtrimit të dyshemeve monolite	4 orë
Tema 3	Teknologjia e shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga)	16 orë
Tema 4	Teknologjia e shtrimit të dyshemeve me materiale të ndryshme	8 orë
Tema 5	Teknologjia e veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme	8 orë
Tema 6	Teknologjia e veshjes me pllaka e mureve të jashtme (fasadave)	8 orë
Tema 7	Teknologjia e rikonstruksionit të dyshemeve dhe veshjeve të mureve të brendshme e të jashtme (fasadave)	6 orë

4. Lënda “Teknologji konstruksionesh mbajtëse” (L-02-177-18). Kl. 12 - 34 orë

• **Synimet e lëndës “Teknologji konstruksionesh mbajtëse”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji konstruksionesh mbajtëse”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë fletët konstruktive të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë me skelet monolit prej betoni të armuar;
- Të interpretojnë fletët konstruktive të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë dykatësh me skelet monolit prej betoni të armuar.
- Të rendisin llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesave.
- Të përshkruajnë elementet konstruktive përbërëse të konstruksioneve prej betoni të armuar.
- Të interpretojnë skica konstruktimi të elementeve të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar.
- Të interpretojnë tabelën e sipërfaqes së armaturës së hekurit (Fa) për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar.
- Të përcaktojnë numrin dhe diametrin (n dhe Ø) të shufrave për Fa të dhënë për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar me përmasa të dhëna.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për pllaka monolite prej betoni të armuar.

- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për trarë monolitë prej betoni të armuar.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për pllakë të përzier me trarë prej betoni të armuar dhe mbushje me tulla te lehtësuara.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për plintin monolit prej betoni të armuar dhe shtyllë monolite prej betoni të armuar dykatëshe.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për mure monolite prej betoni të armuar.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për shkallë monolite prej betoni të armuar.
- Të hartojnë tabelën e specifikimit të armaturës së hekurit për elementet e mësipërme prej betoni të armuar.
- Të përshkruajnë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruksioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura.
- Të përshkruajnë llojet konstruksioneve mbajtëse prej guri e tulle.
- Të përshkruajnë llojet konstruksioneve mbajtëse prej druri e metali.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji konstruksionesh mbajtëse”, kl.12-34 orë**

Tema 1	Konstruksionet mbajtëse dhe elementet përbërëse të tyre	4 orë
Tema 2	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në përkulje (pllaka dhe trarë)	8 orë
Tema 3	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në shtypje (shtylla dhe mure)	4 orë
Tema 4	Parimet bazë për konstruktimin e themeleve prej betoni të armuar (pllakë, trarë dhe plinta)	4 orë
Tema 5	Parimet bazë për konstruktimin e shkallëve prej betoni të armuar	6 orë
Tema 6	Konstruksionet prej betoni të armuar të parapërgatitura	2 orë
Tema 7	Konstruksionet prej betoni të armuar gjysmë të parapërgatitura	2 orë
Tema 8	Konstruksionet prej guri e tulle	2 orë
Tema 9	Konstruksionet prej druri e metali	2 orë

5. Lënda “Teknologji shtrimi rrugësh dhe trotuarësh” (L-02-478-18) kl. 12 – 34 orë

• **Synimet e lëndës “Teknologji shtrimi rrugësh dhe trotuarësh”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji shtrimi rrugësh dhe trotuarësh”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë llojet e rrugëve sipas kategorive të tyre dhe elementet e rrugës
- Të interpretojnë skica të profileve gjatësore dhe tërthore të rrugëve.
- Të përshkruajnë hapat e ndërtimit të shtresave të rrugëve.
- Të përshkruajnë elementet ndërtimore të trotuarëve.
- Të interpretojnë skica të profileve tërthore të trotuarëve.

- Të përshkruajnë elementet ndërtimore të rrjetit inxhinierik në rrugë dhe trotuare.
- Të interpretojnë skica të prerjeve tërthore të rrjetit inxhinierik në rrugë dhe trotuare.
- Të përshkruajnë elementet kryesore ndërtimore të kanaleve e veprave të artit.
- Të përshkruajnë elementet kryesore ndërtimore të urave.
- Të përshkruajnë hapat e vendosjes së bordurave të trotuarëve.
- Të përshkruajnë hapat e shtrimit të trotuarëve me materiale të ndryshme.
- Të përshkruajnë hapat e shtrimit të rrugëve me materiale të ndryshme.
- Të përshkruajnë hapat e shtrimit të dyshemeve te urave me materiale të ndryshme.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji shtrimi rrugësh dhe trotuarësh”, kl.12 - 34 orë**

Tema 1	Njohuri për rrugët dhe trotuarët	8 orë
Tema 2	Shtrimi i rrugëve me materiale të ndryshme	10 orë
Tema 3	Shtrimi i trotuarëve me materiale të ndryshme	8 orë
Tema 4	Njohuri për kanalet ne rruge	4 orë
Tema 5	Njohuri për veprat e artit në rrugë	4 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Punimi i nënshtresave dhe nivelimit të dysHEMEVE”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Shtrim dhe veshje me pllaka
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIMI NËNSHTRESAVE DHE NIVELIT TE DYSHEMEVE	M-02-465-18
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në shtrimin e nënshtresave të nderkateve dhe tarraces, katit përdhe e bodrumit, nivelimin e dysHEMEVE si dhe të llogaritjeve të volumeve dhe materialeve lidhur me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësit kryejnë procese përgatitore për shtrimin e nënshtresave të nderkateve dhe tarraces, katit përdhe e bodrumit dhe nivelimin e dysHEMEVE. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për shtrimin e nënshtresave të nderkateve dhe tarraces, katit përdhe e bodrumit dhe nivelimin e dysHEMEVE.– Interpretimi dhe skicimi i detajeve të nënshtresave të nderkateve dhe tarraces, katit përdhe e bodrumit, dhe nivelimit të dysHEMEVE.– Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës.– Përcaktimi i radhës së punës. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të theksojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për shtrimin e nënshtresave të dysHEMEVE të katit përdhe e bodrumit si dhe për nivelimin e dysHEMEVE.	

- të përgatisin mjetet e punës së vizatimit që nevojiten për skicimin e detajeve të nënshtresave të dyshemeve të katit përdhe dhe bodrumit si dhe të nivelimit të dyshemeve.
- të interpretojnë dhe skicojnë detaje të nënshtresave të dyshemesë së katit përdhe sipas fletës së projektit dhe kushteve teknike të zbatimit.
- të interpretojnë dhe skicojnë detaje të nënshtresave të dyshemesë së bodrumit, sipas fletës së projektit dhe kushteve teknike të zbatimit.
- të interpretojnë dhe skicojnë detaje të nivelimit të dyshemeve sipas fletës së projektit dhe kushteve teknike të zbatimit.
- të përgatisin vendin dhe mjetet e punës sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të përcaktojnë radhën e punës sipas kushteve teknike të zbatimit.

RM 2 Nxënësit shtrojnë nënshtresat e dyshemesë së katit përdhe.

Përmbajtja:

- Kontrolli i kuotës ku do të shtrohen nënshtresat e dyshemesë së katit përdhe.
- Caktimi dhe vendosja e udhëzuesve për trashësinë e shtresës së dheut të ngjeshur.
- Hedhja, lagia dhe ngjeshja e shtresës së dheut të hedhur.
- Shtrimi dhe ngjeshja e shtresës së zhavorrit.
- Shtrimi dhe rrafshimi i shtresës së betonit të varfër.
- Shtrimi i shtresës hidroizoluese.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për shtrimin e nënshtresave të dyshemesë së katit përdhe.
- Sistemimi i vendit të punës pas shtrimit të nënshtresave të dyshemesë së katit përdhe.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtrimit të nënshtresave të dyshemesë së katit përdhe.
- të kontrollojnë kuotën sipas fletës së projektit ku do të shtrohen nënshtresat e dyshemesë së katit përdhe duke përdorur instrumentet matëse e niveluese.
- të caktojnë dhe vendosin udhëzuesit për trashësinë e shtresës së dheut të ngjeshur sipas kushteve teknike të zbatimit.

- të hedhin, lagin dhe ngjeshin shtresën e dheut të hedhur sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të shtrojnë dhe ngjeshin shtresën e zhavorrit sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të shtrojnë dhe rrafshojnë shtresën e betonit të varfër sipas kushteve teknike të zbatimit dhe fletës së projektit.
- të shtrojnë në kohën e duhur shtresën hidroizoluese sipas kushteve teknike të zbatimit dhe fletës së projektit.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për shtrimin e nënshtresave të dyshemesë së katit përdhe.
- të sistemojnë vendin e punës pas mbarimit të shtrimit të nënshtresave të dyshemesë së katit përdhe.

RM 3 Nxënësit shtrojnë nënshtresat e dyshemesë së bodrumit që nuk përmytet.

Përmbajtja:

- Kontrolli i kuotës ku do të ndërtohen nënshtresat e dyshemesë së bodrumit që nuk përmytet.
- Pastrimi dhe lagia e dyshemesë së pllakës së themelit.
- Shtrimi dhe rrafshimi i shtresës së llustrës së çimentos.
- Shtrimi i shtresës hidroizoluese.
- Shtrimi dhe rrafshimi i shtresës së dytë të betonit.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për shtrimin e nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që nuk përmytet.
- Sistemimi i vendit të punës pas ndërtimit të nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që nuk përmytet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që nuk përmytet.
- të kontrollojnë kuotën sipas fletës së projektit ku do të ndërtohen nënshtresat e dyshemesë së bodrumit që nuk përmytet duke përdorur instrumentet matëse e niveluese.
- të pastrojnë dhe lagin dyshemenë e pllakës së themelit sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të shtrojnë dhe rrafshojnë shtresën e llustrës së çimentos sipas kushteve teknike të zbatimit.

- të shtrojnë shtresën hidroizoluese sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të shtrojnë dhe rrafshojnë shtresën e dytë të betonit sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për ndërtimin e nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që nuk përmytet.
- të sistemojnë vendin e punës pas mbarimit të ndërtimit të nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që nuk përmytet.

RMB4 Nxënësit shtrojnë nënshtresat e dyshemesë së bodrumit që përmytet

Përmbajtja:

- Vënia në punë e pompës për largimin e ujit.
- Kontrolli i kuotës ku do të ndërtohen nënshtresat e dyshemesë së bodrumit që përmytet.
- Shtrimi dhe rrafshimi i shtresës së llaçit të çimentos.
- Shtrimi i qilimit hidroizolues në dyshemenë e bodrumit.
- Veshja nga jashtë e murit të bodrumit me qilimin hidroizolues.
- Vendosja e skarës së gatshme dhe betonimi i shtresës së betonit mbi qilimin hidroizolues.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për shtrimin e nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që përmytet.
- Sistemimi i vendit të punës pas shtrimit të nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që përmytet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimin teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtrimit të nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që përmytet.
- të vënë në punë pompën për largimin e ujit sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të kontrollojnë kuotën sipas fletës së projektit ku do të ndërtohen nënshtresat e dyshemesë së bodrumit që përmytet duke përdorur instrumentet matëse e niveluese.
- të shtrojnë dhe rrafshojnë shtresën e llaçit të çimentos 1:2 duke rumbullakosur këndet 90° te muri sipas kushteve teknike të zbatimit.

- të shtrojnë qilimin hidroizolues pas provës së ngurtësimit të llaçit të çimentos, sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të veshin nga jashtë e murin e bodrumit me qilimin hidroizolues pas sigurimit për largimin e lagështisë sipas kushteve teknike të zbatimit .
- të vendosin skarën e gatshme dhe të betonojnë shtresën sipas kushteve teknike të zbatimit dhe fletës së projektit.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për shtrimin e nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që përmytet.
- të sistemojnë vendin e punës pas mbarimit të ndërtimit të nënshtresave të dyshemesë së bodrumit që përmytet.

RM 5 Nxënësit shtrojnë shtresat (niveluese, zeizoluese, hidroizoluese dhe termoizoluese, mbrojtese) te nderkateve, tarraces dhe të katit perdhe/

Përmbajtja:

- Caktimi dhe shënimi i kuotës së dyshemesë së përfunduar të nderkateve, tarraces dhe katit perdhe.
- Shtrimi i shtreses zwizoluese/termoizoluese mbi nderkate/tarrace.
- Shënimi i kuotës me lartësi 1,00 m nga kuota e dyshemesë së përfunduar, në murin e kafazit të shkallës, zhvendosja dhe shënimi i saj në pikat referuese të mureve të mjedisit që shtrohet.
- Shënimi i kuotës së përfundimit të shtresës niveluese të dyshemesë në pikat referuese.
- Fiksimi i drejtueseve per nivelimin e dyshemesë.
- Mbushja dhe rrafshimi i shtresës niveluese të dyshemesë.
- Shtrimi i shtreses hidroizoluese ne mjediset e nderkateve me prani te lageshtise dhe tarrace.
- Shtrimi i shtreses mbrojtese ne tarrace..
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës dhe makinerisë për shtrimin e shtresës niveluese të dyshemesë.
- Sistemimi i vendit të punës pas nivelimit të dyshemesë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimin teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtrimit të shtresës niveluese të dyshemesë.
- të caktojnë dhe shënojnë kuotën e përfundimit të dyshemesë së katit.
- të shënojnë kuotën me lartësi 1,00 m nga kuota e dyshemesë së përfunduar, në murin e kafazit të shkallës, ta zhvendosin dhe shënojnë atë në pikat referuese të mureve të mjedisit që shtrohet duke përdorur instrumentet matëse e niveluese, bazuar te kuota e bazamakut të fundit të shkallës dhe piletës së banjës.
- të shënojnë kuotën e përfundimit të shtresës niveluese të dyshemesë duke u bazuar në shënimet e kuotës së pikave referuese.
- të formojnë takot drejtuese për nivelimin e dyshemesë duke u bazuar në shënimet e kuotës së përfunduar të shtresës niveluese me ndihmën e mjeteve matëse e niveluese.
- të plotësojnë fashaturat me llaç çimento ose të fiksojnë mastarët/ tubat duke u bazuar në takot drejtuese dhe zbatuar kushtet teknike të zbatimit.
- të përgatisin, mbushin me makineri dhe rrafshojnë shtresën niveluese të dyshemesë pas ngurtësimit të fashaturave me ndihmën e mjeteve niveluese.
- të përgatisin, mbushin me krahë dhe rrafshojnë shtresën niveluese të dyshemesë pas ngurtësimit të fashaturave me ndihmën e mjeteve niveluese.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës dhe makinerinë për shtrimin e shtresës niveluese të dyshemesë.
- të sistemojnë vendin e punës pas shtrimit të shtresës niveluese të dyshemesë.

RM 6 Nxënësit kryejnë llogaritje të volumeve te punimeve dhe materialeve të nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve.

Përmbajtja

- Llogaritja e volumeve te punimeve te nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve
- Llogaritja e materialeve per punimet e nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në punimet e nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin detyrimet fiskale të punimeve të nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve, sipas formularëve përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për punime të nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartin e ndërtimit dhe në objekt ndërtimi.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të shtrimit të nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për shtrimin e nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve, si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje konkrete të thjeshta ekonomike të punimeve të nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e shtrimit të nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis pune ndërtimi.
 - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese.
 - Makineri për përgatitjen dhe hedhjen e materialit mbushës për nivelim.
 - Kompleti i veshjes së muratorit.
-

-
- Materialet për nënshtresat dhe nivelimin e dysHEMEVE dhe dysHEMEVE monolite.
 - Materiale niveluese dhe hidroizoluese.
 - Pankarta për për punimet e shtrimit të nënshtresave dhe nivelimit të dysHEMEVE dhe dysHEMEVE monolite..
 - Skica të gatshme për zbatimin e punimeve të shtrimit të nënshtresave, nivelimit të dysHEMEVE dhe dysHEMEVE monolite..
 - Projekte zbatimi.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
-

2. Moduli “Punime shtrimi dyshemesh me copa në mjedise të brendshme dhe të jashtme

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Shtrim dhe veshje me pllaka
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME SHTRIMI DYSHEMESH ME COPA NË MJEDISE TË BRENDSHME DHE TE JASHTME	M-02-1460-18
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në shtrimin e dyshemeve me copa (me fuga), në mjedise të brendshme e te jashtme (rrugë e trotuarë) si dhe në llogaritjet e volumeve dhe materialeve që lidhen me këto lloje punimesh.	
Kohëzgjatja e Modulit	135 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësit kryejnë procese përgatitore për shtrimin e dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe te jashtme (rrugë e trotuarë). Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Udhëzimi për rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për shtrimin e dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe te jashtme (rruge e trotuare)– Interpretimi i skicave të gatshme për shtrimin e dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe te jashtme (rruge e trotuare) me mënyra të ndryshme shtrimi,– Skicimi i fragmenteve të shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga), në mjedise të brendshme dhe te jashtme (rruge e trotuare)– Përgatitja e vendit, e mjeteve dhe e materialeve të punës.– Përcaktimi i radhës së punës. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë:	

- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për shtrimin e dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme, si me: pllaka çimentoje, granili, mermeri e mozaike me copa mermeri, pllaka qeramike, graniti e të pragjeve të dyerve, si dhe për shtrimin e mjediseve sanitare.
- të përgatisin mjetet e punës së vizatimit që i nevojiten për skicimin e fragmenteve të shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga) në mjediset e brendshme.
- të interpretojnë skica të gatshme për shtrimin e dyshemeve me copa (me fuga) në mjediset e brendshme me mënyra të ndryshme shtrimi bazuar në kërkesat arkitektonike.
- të llogaritin e skicojnë sipas përmasave të dyshemesë numrin e radhëve dhe konfiguracionin e pllakave për mënyra të ndryshme shtrimi.
- të përgatisin vendin e punës sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të përgatisin dhe përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës që nevojiten.
- të përcaktojnë radhën e punës sipas kushteve teknike të zbatimit për secilin punim.

RM 2 Nxënësit shtrojnë dyshemenë me pllaka dhe pragjet e dyerve.

Përmbajtja:

- Kontrolli këndeve të drejta të sipërfaqes së dyshemesë.
- Pastrimi dhe lagia e shtresës niveluese.
- Shtrimi i shtresës së llaçit dhe vendosja e pragjeve të gatshme të dyerve.
- Përgatitja e llaçit/kolles .
- Fiksimi i pllakave udhëzuese në katër qoshet e sipërfaqes dhe vendosja e spangos.
- Shtrimi i shtresës së llaçit/kollws dhe vendosja e pllakave të dy radhëve të para pingule.
- Shtrimi i shtresës së llaçit/kollws dhe vendosja e pllakave të radhëve të tjera.
- Plotësimi i sipërfaqeve të paplotësuara me pllaka të prera
- Vendosja e plintusave.
- Pastrimi i fugave, hedhja e bojakës dhe pastrimi i sipërfaqes së shtruar dhe i plintusave.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës dhe makinerive për shtrimin e dyshemesë
- Sistemimi i vendit të punës pas shtrimit të dyshemesë

me pllaka çimentoje e granili.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtrimit të dyshemesë me pllaka çimentoje, granili, mermeri e mozaike me copa mermeri.
- të kontrollojnë këndet e drejta të sipërfaqes së dyshemesë me instrumente matëse, skuadër e spango për dy diagonalet.
- të pastrojnë dhe lagin shtresën niveluese pas ngurtësimit të saj sipas kushteve teknike.
- të përgatitin me makineri llaçin e çimentos sipas recepturave të dhëna.
- të fiksojnë pllakat udhëzuese në katër qoshet duke kontrolluar nivelimin e tyre me mastar-nivelë në shenjën e kuotës së përfunduar të dyshemesë dhe të vendosin spangon për drejtim.
- të shtrojnë shtresën e llaçit dhe të vendosin pllakat e të dy radhëve të para pingule duke kontrolluar çdo pllakë me mjete matëse e niveluese.
- të shtrojnë shtresën e llaçit dhe të vendosin pllakat e radhëve të tjera duke kontrolluar nivelimin e tyre me mjete matëse e niveluese si dhe fugat në dy drejtimet pingule.
- të shtrojnë shtresën e llaçit dhe të vendosin pragjet e gatshme të dyerve duke kontrolluar nivelimin me mastar-nivelë.
- të plotësojnë sipërfaqet e paplotësuara me pllaka të prera çimentoje, granili, mermeri e mozaike me copa mermeri, duke kontrolluar nivelimin me mastar-nivelë.
- të vendosin në kohën e duhur plintusat e gatshëm duke kontrolluar me mjete matëse e niveluese.
- të pastrojnë fugat, të hedhin bojakën e çimentos deri sa të plotësohet çdo boshllëk i fugave dhe të pastrojnë sipërfaqen e shtruar dhe të plintusave sipas kërkesave teknike.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës dhe makinerinë e përgatitjes së llaçit, për shtrimin e dyshemesë me pllaka çimentoje, granili, mermeri e mozaike me copa mermeri.
- të sistemojnë vendin e punës pas shtrimit të dyshemesë me pllaka çimentoje, granili, mermeri e mozaike me copa mermeri.

RM 3 Nxënësit shtrojnë nënshtresat dhe dyshemetë e mjediseve sanitare.

Përmbajtja:

- Kontrolli i kuotës së dyshemesë së përfunduar të katit.
- Fiksimi drejtueseve për dhënie e pjerrësisë së dyshemesë së mjedisit sanitar.
- Mbushja midis fashaturave me materialin mbushës-nivelues dhe rrafshimi i tij.
- Vendosja e shtresës hidroizoluese në dyshemenë dhe muret e mjedisit sanitar.
- Fiksimi i pllakave referuese.
- Shtrimi i llaçit/kolles dhe vendosja e pllakave të tjera së bashku me kryqet.
- Prerja dhe shtrimi i pllakave në vendet bosh.
- Heqja e kryqeve dhe pastrimi i fugave.
- Përgatitja, hedhja e bojakës dhe fshirja e pllakave
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për shtrimin e dyshemeve të mjediseve sanitare.
- Sistemimi i vendit të punës pas shtrimit të dyshemeve të mjediseve sanitare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtrimit të dyshemeve të mjediseve sanitare.
- të kontrollojnë kuotën e dyshemesë së përfunduar të katit.
- të formojnë takot referuese për dhënie e pjerrësisë së dyshemesë së mjedisit sanitar duke i u referuar kuotës së piletës së vendosur më parë.
- të plotësojnë fashaturat me llaç çimento duke kontrolluar rrafshtësinë sipas pjerrësisë së formuar me takot referuese.
- të mbushin në kohën e duhur midis fashaturave me materialin mbushës-nivelues dhe ta rrafshojnë atë me mastar duke kontrolluar rrafshtësinë sipas fashaturave.
- të shtrojnë shtresën dhe rumbullakojnë këndet me llaç çimentoje 1:2 sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të ngjitin në kohën e duhur pas ngurtësimit të llaçit të çimentos shtresën hidroizoluese në dyshemenë dhe muret e mjedisit sanitar deri në lartësinë e duhur.
- të fiksojnë me llaç çimentoje pllakat referuese duke

kontrolluar rrafshtësinë sipas pjerrësinë së formuar më parë .

- të htrojnë llaçin e çimentos dhe vendosin pllakat e tjera së bashku me kryqet duke kontrolluar rrafshtësinë sipas pjerrësinë së formuar më parë.
- të presin dhe shtrojnë pllakat në vendet e piletës, të tubit të shkarkimit dhe të pllakës qeramike të dushit ose vaskës sipas projektit.
- të heqin kryqet dhe pastrojnë fugat sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të përgatisin bojakën sipas kërkesës, ta hedhin atë në fuga deri sa të mos mbetet boshllëk në to dhe pastrojnë sipërfaqen e shtruar.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për shtrimin e dysHEMEVE të mjediseve sanitare.
- të sistemojnë vendin e punës pas shtrimit të dysHEMEVE të mjediseve sanitare.

RM 4 Nxënësit ndërtojnë trotuarin e ndërtesës.

Përmbajtja:

- Piketimi dhe gërmimi i gjerësisë së trotuarit.
- Kontrolli dhe shënimi në faqen e xokolit të kuotës së përfunduar të trotuarit.
- Ndërtimi i niveluesve të bordurave me beton te varfer
- Vendosja dhe fiksimi me beton te bordurave të gatshme.
- Ngjeshja e dheut të bazamentit të trotuarit.
- Shtrimi dhe ngjeshja e shtresës së zhavorrit.
- Përgatitja e betonit të varfër, shtrimi dhe rrafshimi i tij me pjerresi.
- Shtrimi i shtreses hidroizouese mbi beton deri ne nje lartesi te murit.
- Shtrimi dhe rulimi i pllakave sipas gjerësisë së trotuarit.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për ndërtimin e trotuareve të ndërtesës.
- Sistemimi i vendit të punës pas ndërtimit të trotuarit të ndërtesës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të trotuarit të ndërtesës.
- të piketojnë dhe gërmojnë gjerësinë e trotuarit sipas projektit.
- të kontrollojnë dhe shënojnë në faqen e xokolit kuotën e

- përfunduar të trotuarit sipas projektit.
- të ndërtojnë fashaturat gjatësore të bordurave me llaç çimentoje duke kontrolluar nivelimin me instrumente matëse e niveluese.
 - të vendosin dhe fiksojnë me llaç çimentoje bordurat e gatshme sipas fashaturave dhe drejtimit të spangos.
 - të ngjeshin dheun e bazamentit të trotuarit sipas kuotës së dhënë.
 - të shtrojnë dhe ngjeshin me makineri shtresën e zhavorrit me trashësinë e dhënë.
 - të përgatitin betonin e varfër me makineri sipas markës së dhënë.
 - të shtrojnë betonin e varfër dhe rrafshojnë atë duke i dhënë drejtimin e pjerrësisë sipas projektit nga xokoli te bordura.
 - të shtrojnë llaçin e përzier dhe vendosin pllakat e para sipas gjerësisë së trotuarit duke kontrolluar rrafshhtësinë me mastar-nivelë.
 - të shtrojnë llaçin e përzier dhe vendosin pllakat e tjera sipas gjatësisë së trotuarit duke kontrolluar rrafshhtësinë me instrumentet matëse e niveluese.
 - të pastrojnë fugat, përgatitin bojakën e çimentos dhe mbushja e fugave me të sipas kushteve teknike të zbatimit.
 - të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës dhe makineritë për ndërtimin e trotuarit të ndërtesës.
 - të sistemojnë vendin e punës pas ndërtimit të trotuarit të ndërtesës.

RM 5 Nxënësit shtrojnë me pllaka rrugët dhe trotuaret e tyre.

Përmbajtja:

- Germimi, dhe caktimi i kuotës së shtresave (zhavorrit, çakellit, stabilizantit, betonit dhe reres).
- Shtrimi dhe ngjeshja e shtresave te mesiperme.
- Kontrolli i kuotës së shtresave të rrugës e trotuarwve.
- Vendosja e pllakave në rrugë dhe trotuarw.
- Ngjeshja e pllakave me makineri (rul).
- Mbushja e fugave me rërë dhe pastrimi i sipërfaqes së rrugës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të rikujtojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtrimit me pllaka në rrugë e trotuare.

- Të kontrollojnë kuotën e shtresës së betonit të trotuarit.
- Të kontrollojnë kuotën e shtresës së asfaltobetonit të rrugës.
- Të shënojnë kuotën e përfunduar të sipërfaqes së rrugës.
- Të vendosin takot dhe të formojnë fashaturat në rrugë.
- Të hedhin dhe rrafshojnë shtresën e rërës.
- Të vendosin pllakat e rrugës.
- Të ngjeshin pllakat me makineri (rul).
- Të mbushin fugat me rërë dhe të pastrojnë sipërfaqen e rrugës.
- Të hedhin dhe të rrafshojnë shtresën e rërës në trotuare.
- Të vendosin dhe ngjeshin pllakat e trotuarëve.
- Të mbushin fugat me rërë dhe të pastrojnë sipërfaqen e trotuarëve.

RM 6 Nxënësit kryejnë llogaritje të volumeve të punimeve dhe materialeve të shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme e të jashtme (rruge e trotuare).

Përmbajtja

- Llogaritja e volumeve të shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe të jashtme (rruge e trotuare).
- Llogaritja e materialeve për punimet e nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e shtrimit të dyshemesë me copa (fuga) në mjedise të brendshme, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin detyrimet fiskale të punimeve të shtrimit të dyshemesë me copa (fuga) në mjedise të brendshme, sipas formularëve përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për punime të shtrimit të dyshemesë me copa (fuga) në mjedise të brendshme.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartin e ndërtimit dhe objekt ndërtimi
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të shtrimit të dyshemesë me copa (fuga) në mjedise të brendshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e proceseve të punës të shtrimit të dyshemesë me copa (fuga) në mjedise të brendshme, si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje të thjeshta ekonomike në lidhje me shtrimin e dyshemesë me copa (fuga) në mjedise të brendshme.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e shtrimit të dyshemesë me copa (fuga) në mjedise të brendshme, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me të.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis pune ndërtimi ose objekt ndërtimi
- Mjetet, instrumentet matëse e niveluese
 - Kompleti i veshjes së muratorit
 - Materialet për shtrimin e dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe sanitare
 - Pankarta për punimin e shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe sanitare.
 - Skica të gatshme për zbatimin e punimit të shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe sanitare
 - Projekte zbatimi.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e shtrimit të dyshemeve me copa (me fuga) në mjedise të brendshme dhe sanitare (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

3. Moduli “Veshja me pllaka e mureve të mjediseve të brendshme”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Shtrim dhe veshje me pllaka
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VESHJA ME PLLAKA E MUREVE TE MJEDISEVE TË BRENDSHME	M-02-469-18
------------------	--	--------------------

Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për veshjen me pllaka të mureve në mjediset sanitare, bazamakëve të shkallës, davancave, shpatullave të dyer-dritareve, shtyllave, vendosjen e plintusave si dhe në llogaritjet e volumeve dhe materialeve që lidhen me këto lloje punimesh.
-------------------	--

Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore
-----------------------	------------------

Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.
---------------------------------	---

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësit kryejnë procese përgatitore për veshjen e mureve me pllaka të mjediseve të brendshme.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Udhëzimi për rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për veshjen me pllaka të: mureve të mjediseve sanitare, bazamakëve të shkallës, davancave, shpatullave të dyer-dritareve dhe shtyllave.– Skicimi i fragmenteve të veshjes me pllaka të: mureve të mjediseve sanitare, bazamakëve të shkallës, davancave, shpatullave të dyer-dritareve dhe shtyllave.– Përgatitja e skelës së gatshme.– Përgatitja e vendit, e mjeteve dhe e materialeve të punës.– Përcaktimi i radhës së punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për veshjen me pllaka të: mureve të mjediseve
---	--

-
- sanitare, bazamakëve të shkallës, davancave, shpatullave të dyer-dritareve dhe shtyllave.
- të përgatisin mjetet e punës së vizatimit që i nevojiten për skicimin e fragmenteve të veshjes me pllaka të mjediseve të brendshme.
 - të interpretojnë skica të gatshme për veshjen me pllaka të: mureve të mjediseve sanitare, bazamakëve të shkallës, davancave, shpatullave të dyer-dritareve dhe shtyllave sipas mënyrave të veshjes dhe kërkesave arkitektonike.
 - të llogaritin e skicojnë sipas përmasave të sipërfaqeve të murit numrin e radhëve dhe konfiguracionin e pllakave.
 - të përgatisin vendin e punës sipas kushteve teknike të zbatimit.
 - të përgatisin skelën e gatshme për punë dhe ta fiksojnë atë.
 - të përgatisin dhe përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës që nevojiten.
 - të përcaktojnë radhën e punës sipas kushteve teknike të zbatimit për secilin punim.

RM 2 Nxënësit veshin me pllaka muret në mjediset sanitare.

Përmbajtja.

- Kontrolli i rrafshhtësisë dhe vertikalishtetit të sipërfaqes së murit që do të vishet me pllaka.
- Përgatitja e sipërfaqes së murit që do të vishet me pllaka.
- Përzgjedhja dhe përgatitja e pllakave dhe materialit ngjitës për veshjen e murit.
- Caktimi i kuotës dhe fiksimit i mastar-nivelit ku do të fillojë radha e parë e veshjes me pllaka.
- Shtrimi i materialit ngjitës dhe vendosja e pllakave të radhës së parë së bashku me kryqet dhe e pllakave plotësuese të prera.
- Shtrimi i materialit ngjitës, vendosja e pllakave të radhëve të tjera së bashku me kryqet e shiritat dekorativë dhe e pllakave plotësuese të prera.
- Fiksimit i këndoreve të gatshme.
- Heqja e mastar-nivelës dhe plotësimi i radhës së pllakave mbi dysheme së bashku me kryqet dhe e pllakave plotësuese të prera.
- Heqja e kryqeve dhe pastrimi i fugave.
- Përgatitja, hedhja e bojakës dhe fshirja e pllakave.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e veglave të dorës për veshjes e mureve të mjediseve sanitare.

- Sistemimi i vendit të punës pas veshjes së mureve të mjediseve sanitare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veshjes së mureve të mjediseve sanitare.
- të kontrollojë rrafshhtësinë dhe vertikalishtet e sipërfaqes së murit që do të vishet me pllaka me instrumentet matëse e niveluese.
- të përgatitin sipërfaqen e murit që do të vishet me pllaka duke lagur e kontrolluar ashpërsinë e murit.
- të përzgjedhin dhe përgatitin pllakat duke i lagur dhe përgatitin materialit ngjitës të gatshëm më ujë sipas recepturave të dhëna.
- të caktojnë kuotën dhe fiksojnë mastar-nivelin ku do të fillojë radha e parë e veshjes me pllaka duke kontrolluar nivelimin me instrumentet matëse e niveluese.
- të shtrojnë materialin ngjitës dhe vendosin pllakat e radhës së parë së bashku me kryqet, presin pllakat sipas përmasës së hapësirës bosh e i vendosin ato duke kontrolluar rrafshhtësinë dhe vertikalishtet me instrumentet matëse e niveluese.
- të shtrojnë materialin ngjitës, vendosin pllakat e radhëve të tjera së bashku me kryqet e shiritat dekorativë, presin pllakat sipas përmasës së hapësirës bosh e i vendosin ato duke kontrolluar rrafshhtësinë dhe vertikalishtet me instrumentet matëse e niveluese.
- të fiksojnë këndoret e gatshme sipas pllakave të vendosura më parë.
- të heqin mastar-nivelën dhe plotësojnë radhën e pllakave mbi dysheme së bashku me kryqet dhe presin pllakat sipas përmasës së hapësirës bosh e i vendosin ato duke kontrolluar rrafshhtësinë dhe vertikalishtet me instrumentet matëse e niveluese.
- të heqin kryqet dhe pastrojnë fugat sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të përgatitin bojakën sipas kërkesave për ngjyrën, mbushin fugat deri sa të mos ketë boshllëk dhe fshijnë në kohën e duhur pllakat.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë veglat e dorës për veshjen e mureve të mjediseve sanitare.
- të sistemojnë vendin e punës pas veshjes së mureve të

mjediseve sanitare.

RM 3 Nxënësit veshin me pllaka bazamakët e shkallës.

Përmbajtja:

- Kontrolli i nivelimit dhe vertikalitetit të sipërfaqes së bazamakut (shkeljes dhe ngjitjes) që do të vishen.
- Caktimi dhe shënimi në mur i vijës së pjerrësisë së cepave të përfunduar të pllakave veshëse horizontale të bazamakëve.
- Përgatitja dhe lagia e sipërfaqes së betonit të bazamakut që do të vishet.
- Përgatitja e llaçit të çimentos.
- Shtrimi i llaçit të çimentos dhe vendosja e pllakës veshëse vertikale të bazamakut.
- Shtrimi i llaçit të çimentos dhe vendosja e pllakës veshëse horizontale të bazamakut.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e veglave të dorës për veshjen me pllaka të bazamakëve të shkallës.
- Sistemimi i vendit të punës pas veshjes me pllaka të bazamakëve të shkallës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veshjes me pllaka të bazamakëve të shkallës.
- të kontrollojë nivelimin dhe vertikalitetin e sipërfaqes së bazamakut (shkeljes dhe ngjitjes) dhe shpatullave të dyer-dritareve si dhe nivelimin e davancalit me instrumentet matëse e niveluese dhe skuadër.
- të caktojnë dhe shënojnë në mur vijën e pjerrësisë së cepave të përfunduar të pllakave veshëse horizontale të bazamakëve.
- të përgatitin dhe lagin sipërfaqen e betonit të bazamakut që do të vishet sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të përgatitin me krahë llaçin e çimentos sipas recepturave të dhëna.
- të shtrojnë llaçin e çimentos, vendosin dhe fiksojnë me përforcues pllakën veshëse vertikale të bazamakut duke respektuar kuotën e përfunduar të katit (sheshpushimit) dhe duke kontrolluar vertikalitetin me instrumentet matëse e niveluese.
- të shtrojnë llaçin e çimentos, vendosin pllakë veshëse

- horizontale të bazamakut duke respektuar vijën e pjerrësisë dhe kontrolluar nivelimin me mastar-nivelë.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë veglat e dorës për veshjen me pllaka të bazamakëve të shkallës.
- të sistemojnë vendin e punës pas veshjes me pllaka të bazamakëve të shkallës

RM 4 Nxënësit veshin me pllaka shpatullat e dyer-dritareve dhe davancalet.

Përmbajtja:

- Kontrolli i vertikalishtit të sipërfaqes së shpatullave të dyer-dritareve si dhe nivelimit të davancaletit të dhe arkitrarëve të dyer-dritareve dhe parapeteve që do të vishen.
- Kontrolli i përmasës së hapësirës dritë, kontrolli dhe shënimi i kuotës së davancaletit dhe arkitrarit të derës, dritares dhe parapetit.
- Përgatitja dhe lagia e sipërfaqeve që vishet të shpatullave e davancaleve të dyer-dritareve dhe parapetit.
- Shtrimi i llaçit të çimentos dhe vendosja e pllakës veshëse horizontale të davancaletit të dritares dhe parapetit.
- Shtrimi i llaçit të çimentos dhe vendosja e pllakave vertikale në dy faqet e derës.
- Shtrimi i llaçit të çimentos, vendosja e pllakës veshëse horizontale të derës dhe dritares dhe e përforcuesit vertikal.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e veglave të dorës për veshjen me pllaka të shpatullave të dyer-dritareve dhe davancaleve.
- Sistemimi i vendit të punës pas veshjes me pllaka të shpatullave të dyer-dritareve dhe davancaleve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të rikujtojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veshjes me pllaka të shpatullave të dyer-dritareve dhe davancaletit.
- të kontrollojnë vertikalishtin e sipërfaqes së shpatullave të dyer-dritareve si dhe nivelimin e davancaletit të dhe arkitrarëve të dyer-dritareve dhe parapeteve që do të vishen.
- të kontrollojnë përmasat hapësirave dritë, kontrollojnë dhe shënojnë kuotën e davancaletit dhe arkitrarit të derës, dritares dhe parapetit sipas fletës së projektit me

mjetet matëse, niveluese e shënuese.

- të përgatitin dhe lagin sipërfaqet që vishen të shpatullave e davancaleve të dyer-dritareve dhe parapetit sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të shtrojnë llaçin e çimentos dhe vendosin pllakën veshëse horizontale të davançalit të dritares dhe parapetit duke kontrolluar nivelimin me instrumentet matëse e niveluese.
- të shtrojnë llaçin e çimentos dhe vendosin pllakat vertikale në dy faqet e derës duke kontrolluar vertikalisht me instrumentet matëse e niveluese.
- të shtrojnë llaçin e çimentos, vendosin pllakën veshëse horizontale në kuotën e arkitrarit të derës dhe dritares duke kontrolluar nivelimin me instrumentet matëse e niveluese dhe vendosin përforcuesin vertikal .
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë veglat e dorës për veshjen me pllaka të shpatullave të dyer-dritareve dhe davancaleve.
- të sistemojnë vendin e punës pas veshjes me pllaka të shpatullave të dyer-dritareve dhe davancaleve.

RM 5 Nxënësit veshin shtyllën me pllaka.

Përmbajtja

- Kontrolli i rrafshhtësisë dhe vertikalisht të sipërfaqeve të shtyllës që do të vishet me pllaka.
- Përgatitja dhe lagia e sipërfaqes së betonit të shtyllës që do të vishet me pllaka.
- Përzgjedhja dhe përgatitja e pllakave, këndoreve dhe materialit ngjitës për veshjen e shtyllës.
- Fiksimi i mastar-nivelës për radhët e para të pllakave.
- Shtrimi i materialit ngjitës dhe vendosja e pllakave të radhës së parë të çdo faqeje të shtyllës.
- Shtrimi i materialit ngjitës, vendosja e pllakave të radhëve të tjera.
- Fiksimi i këndoreve të gatshme.
- Heqja e mastar-nivelës dhe plotësimi i radhës së pllakave mbi dysheme.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e veglave të dorës për veshjen e shtyllës me pllaka.
- Sistemimi i vendit të punës pas veshjes së shtyllës me pllaka.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të rikujtojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veshjes së shtyllës me pllaka
- të kontrollojë rrafshtësinë dhe vertikalitetin e sipërfaqes së shtyllës që do të vishet me pllaka me instrumentet matëse e niveluese.
- të përgatitin sipërfaqet e betonit të shtyllës që do të vishet me pllaka duke i lagur ato sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të përzgjedhin dhe përgatitin pllakat, këndorët dhe të përgatitin materialit ngjitës të gatshëm më ujë sipas recepturave të dhëna.
- të fiksojnë mastar-nivelin ku do të fillojë radha e parë e veshjes me pllaka të çdo faqeje të shtyllës duke kontrolluar nivelimin me instrumentet matëse e niveluese.
- të shtrojnë materialin ngjitës dhe vendosin pllakat e radhës së parë të çdo faqeje të shtyllës duke kontrolluar rrafshtësinë dhe vertikalitetin me instrumentet matëse e niveluese.
- të shtrojnë materialin ngjitës, vendosin pllakat e radhëve të tjera duke kontrolluar rrafshtësinë dhe vertikalitetin me instrumentet matëse e niveluese.
- të fiksojnë këndoret e gatshme sipas pllakave të vendosura më parë.
- të heqin mastar-nivelën dhe plotësojnë radhën e pllakave mbi dysheme duke kontrolluar rrafshtësinë dhe vertikalitetin me instrumentet matëse e niveluese.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë veglat e dorës për veshjen e shtyllës me pllaka.
- të sistemojnë vendin e punës pas veshjes së kollonës me pllaka.

RM 6 Nxënësit kryejnë llogaritje të veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme.

Përmbajtja

- Llogaritja e volumeve per punimet e veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme
- Llogaritja e materialeve per punimet e veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në punimet e veshjes me pllaka të

mureve të mjediseve të brendshme, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.

- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin detyrimet fiskale në punime të veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme, sipas formularëve përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për punime të veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartin e ndërtimit ose në objekt ndërtimi.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve për veshjen me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për veshjen me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme, si dhe për përdorimin e mjeteve e makinerive dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje të thjeshta ekonomike në lidhje me punimin e veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe të mirëmbajtjes së mjeteve e makinerive dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve e makinerive të punës, për realizimn e veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis pune ndërtimi ose objekt ndërtimi
 - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese
 - Komplet i veshjes së muratorit
 - Materialet për veshjen me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme
 - Skela të gatshme
 - Pankarta për punimin e veshjes me pllaka të mureve të
-

mjediseve të brendshme

- Skica të gatshme për zbatimin e punimit të veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme
 - Projekte zbatimi për veshjen me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për koston e punimeve
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e veshjen me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme
 - (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

4. Moduli “Veshja me pllaka e fasadave”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Shtrim dhe veshje me pllaka
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>	
Titulli dhe kodi	VESHJA ME PLLAKA E FASADAVE M-02-470-18
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në veshjen e mureve të fasadave me pllaka të ndryshme dhe materiale të tjera
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe përmbajtja	<p>RM 1 Nxënësit kryejnë procese përgatitore për veshjen e mureve të fasadave me pllaka të ndryshme dhe materiale të tjera.</p> <p><i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Rikujtimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veshjes së mureve të fasadave me pllaka të ndryshme dhe materiale të tjera– Interpretimi dhe skicimi i fragmenteve të veshjes së mureve të fasadave me pllaka të ndryshme dhe materiale të tjera me mënyra të ndryshme.– Fiksimi i skelës së gatshme me konstruksionin e ndërtesës dhe vendosja e rrjetës mbrojtëse.– Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve të punës për veshjen e xokolit dhe fasadave me pllaka të ndryshme dhe materiale të tjera.– Përgatitja e vendit, e mjeteve dhe e materialeve të punës.– Përcaktimi i radhës së punës. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të rikujtojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veshjes së fasadave (dekorative) me pllaka graniti, qeramike e tesarina.– të interpretojnë dhe skicojnë fragmente të veshjes së fasadave (dekorative) me pllaka graniti, qeramike e

-
- teserina me mënyra të ndryshme sipas kërkesave arkitektonike të projektit.
 - të fiksojnë skelën e gatshme me konstruksionin e ndërtesës dhe vendosin rrjetës mbrojtëse sipas kushteve teknike të zbatimit.
 - të për zgjedhin materialet, veglat dhe pajisjet e punës për veshjen e fasadave (dekorative) me pllaka graniti, qeramike e teserina.
 - të përgatitin vendin, mjetet dhe materialet e punës sipas kërkesave teknike.
 - të përcaktojnë radhën e punës sipas kërkesave teknike.

RM 2 Nxënësit veshin fasadën me pllaka te ndryshme dhe materiale te tjera.

Përmbajtja

- Kontrolli i rrafshhtësisë së sipërfaqes së fasadës.
- Pastrimi dhe përgatitja e sipërfaqes së fasadës për veshje.
- Fiksimi i mastar–nivelës për veshjen me pllaka te ndryshme të radhës së parë dhe materiale te tjera.
- Përgatitja e materialit ngjitës.
- Shtrimi i materialit ngjitës dhe vendosja e pllakave të radhës së parë.
- Shtrimi i materialit ngjitës dhe vendosja e pllakave të radhëve të tjera.
- Përpunimi i pllakave plotësuese sipas hapësirave boshe dhe i detajeve të tjera.
- Shtrimi i materialit ngjitës dhe vendosja e pllakave plotësuese dhe e detajeve.
- Pastrimi i fugave të pllakave.
- Përgatitja dhe hedhja e bojakës në fugat e pllakave.
- Pastrimi i sipërfaqes së veshur me pllaka te ndryshme.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës gjatë veshjes së fasadave (dekorative) me pllaka te ndryshme dhe materiale tw tjera.
- Sistemimi i vendit të punës pas veshjes së fasadave (dekorative) me pllaka graniti dhe qeramike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimin teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veshjes me pllaka graniti dhe qeramike.

- të kontrollojnë rrafshhtësinë e sipërfaqes së fasadës me instrumente matëse e niveluese.
- të pastrojnë dhe përgatitin sipërfaqen e fasadës për veshje duke ruajtur ashpërsinë sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të fiksojnë mastar–nivelën për veshjen me pllaka graniti dhe qeramike të radhës së parë duke kontrolluar nivelimin dhe pozicionin e vendosjes sipas skicës së dhënë.
- të përgatitin materialin ngjitës sipas recepturave të dhëna.
- të shtrojnë materialin ngjitës dhe vendosin e pllakat e radhës së parë duke respektuar skicën e dhënë dhe kontrollojnë nivelimin dhe vertikalishtet me instrumente matëse e niveluese.
- të shtrojnë materialin ngjitës dhe vendosin pllakat e radhëve të tjera duke respektuar skicën e dhënë dhe kontrollojnë nivelimin dhe vertikalishtet me instrumente matëse e niveluese.
- të përpunojnë pllakat plotësuese sipas hapësirave boshe dhe detajet e tjera duke matur përmasat.
- të shtrojnë materialin ngjitës dhe vendosin pllakat plotësuese e detajet duke respektuar skicën e dhënë dhe kontrollojnë nivelimin dhe vertikalishtet me instrumente matëse e niveluese.
- të pastrojnë fugat e pllakave sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të përgatitin sipas kërkesës dhe hedhin bojakën në fugat e pllakave deri sa ato të mbushen plotësisht.
- të pastrojnë sipërfaqen veshur me pllaka graniti dhe qeramike sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës gjatë veshjes së fasadave (dekorative) me pllaka graniti dhe qeramike sipas kushteve teknike të zbatimit.
- të sistemojnë vendin e punës pas veshjes së fasadave (dekorative) me pllaka graniti dhe qeramike sipas kushteve teknike të zbatimit.

RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të volumeve të punimeve dhe materialeve të veshjes së mureve të fasadave
Përmbajtja

Llogaritja e volumeve të punimeve të veshjes me pllaka të ndryshme dhe materiale të tjera të mureve të fasadave.

- Llogaritja e materialeve për punimet e veshjes me pllaka të ndryshme dhe materiale të tjera të

mureve te fasadave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

